

FILLOI SEMINARI PËR MBËSHTETJE TË ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË

Kërkohet ngritje e partneritet mes Universitetit të Prishtinës dhe atij të Austrisë

Drejtues të organizatës WUS - Austria thonë se organizata e tyre nuk është përgjegjëse për punët që duhet t'i përfundojë Ministria e Arsimit, por detyrë e tyre është që të mundohen t'i shtrojnë, debatojnë dhe diskutojnë problemet që kanë të bëjnë me arsimin

Bukurije Maksutaj

Prishtine

Me qëllim të njohjes së zhvillimeve më të fundit në fushën e arsimit të lartë dhe zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Prishtinës dhe Austrisë, të mërkurën është organizuar një seminar me temën "Zhvillimi i programeve të përbashkëta dhe njohjet akademike". Në këtë konferencë nga panelistët u tha se ka një mori të punëve në fushën e arsimit që duhet të përfundohen, punë të cilat janë në kompetencë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe institucioneve të arsimit të lartë të Kosovës. Drejtori rajonal i OJQ-së WUS-t nga Austria me seli në Prishtinë, But Dedaj, ka thënë se organizata e tyre nuk është përgjegjëse për punët që duhet t'i përfundojë Ministria e Arsimit, por detyrë e tyre është për t'i shtruar, debatuar dhe diskutuar problemet. "Ky semi-

nar dyditor ka për qëllim zhvillimin e programeve të përbashkëta në mes të studentëve të Universitetit të Prishtinës dhe studentëve të Austrisë. Në seminar u diskutua se cila është korniza ligjore që kërkohet, pasqaj se si duhet të harmonizohen aplikacionet, si duhet të janë planet mësimore, planprogramet mësimore, mësimdhënia, metodologja e mësimdhënieς, evoluimi dhe segmenti më relevant për tregun e punës, në mënyrë që dy këto institucione, si ai i Austrisë dhe Kosovës, të kenë bashkëpunimi ndërshtetëror", tha Dedaj. Ai tha se organizata e tyre ka programe të frytshme për sa i përket sjelljes së dijes nga diaspora, i ashuquajturi program i zhvillimit të trurit, që nënkupton ardhjen e ekspertëve nga diaspora për të mbajtur cikle të ligjératave prej 1 deri në 3 javë. "Kemi pasur mbi 70 profesorë që kanë ardhur deri tani. Janë mbajtur mbi 130 ligjérata të ndryshme, do të thotë disa ekspert kanë ardhur edhe 2-

3 herë. Mirëpo, kohëve të fundit i kemi përbledhur këto aktivitete tonat në zhvillimin e katër master programeve. Këto master programe janë në vijim e sipër. Ato kanë filluar në vitin akademik 2009-2010. Në Fakultet Juridik zbatohen dy programe master. E drejta ndërkombëtare dhe E drejta pronësoro-civile. Duke pasur parasysh strukturën e studimeve në këtë fakultet, që zgjasin katër vite, programi master është një vit, prandaj këto dy programe të masterit veçse kanë përfunduar ligjératat pasi që kanë qenë vetëm dy semestra, ndërkohë studentët janë duke përgatitur temat e magistraturës. Programi i tretë master është i zhvilluar në mekatronikë, projekt i cili është intro-disiplinar. Projekti i katërt është Menaxhmenti Shëndetësor, që zbatohet në Fakultetin e Mjekësisë. E veçanta e tyre është se të gjitha janë zhvilluar në bashkëpunim shumë të ngushtë me universitetet partnere të Austrisë", theksoi Dedaj. Ai ka

treguar se në kuadër të këtij programi master kanë qenë të para-para edhe dy seminare për t'u mbajtur, me qëllim të ngritjes së vetëdijes që zhvillimi i kurrikulit duhet të jetë në harmoni me nevojat e ekonomisë. "Prezantues të këtij programi janë tre ekspertë nga Evropa, të cilët do të jepin kontribut në këtë seminar. Tia Loukkola nga Asociacioni i Univeristeteve Evropiane, (European University Association (EUA), Heinz Kasparovski nga Austria, udhëheqës i zyrës, Enic Naric, në Austri, si dhe Elisabeth Fiorioli, eksperte evropiane për programet e përbashkëta dhe njohjet, gjithashtu është edhe anëtarë e bordit të Agjencionit të Akreditimit të Kosovës. Po ashtu kontributin kryesor do e jepin edhe ekspertët vendas, të cilët do të marrin pjesë në prezantime krahas atyre të Evropës, që do të kenë një rol të rëndësishëm", tha ai. Dedaj shtoi se gjatë seminarit dyditor do të kërkohet një partneritet me Universitetin e

Prishtinës dhe atë të Austrisë, në mënyrë që së bashku të zhvillojnë një program master, baçelor dhe program bizhdhi, në mënyrë që studentët që pajisen me diploma, ato t'ju njihen edhe në Austrasi dhe vendet e tjera. "Organizimi i këtij seminarit qëllim kryesor ka njohjen e zhvillimeve me të fundit në fushën e arsimit të lartë. Në këtë aspekt, zhvillimi i programeve të përbashkëta përfaqëson trendin më të fundit në zonën evropiane të arsimit të lartë dhe më gjerë. Pjesëmarrës në këtë seminar dyditor janë përfaqësues të Universitetit të Prishtinës, përfaqësues relevantë të arsimit të lartë të Kosovës, organizata të ndryshme si dhe myafirë nga Mali Zi. Kjo konferencë do të vazhdojë edhe sot. Organizata WUS-t nga Austria operon në Kosovë që nga viti 1998 dhe fokus kryesor i aktiviteteve të kësaj organizate ndërkombëtare të Austrisë është arsimi i lartë në Kosovë, zhvillimi i kurrikulit, lidhja e arsimit të lartë me ekonominë.